PROGRAM I CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT

BACHELOR NË "MËSUESI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR"

Emertimi akademik i studimit	**Diplomë Universitare Bachelor Në "Mësuesi në Arsimin Parashkollor"**
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr. 05 , datë 10.01.2025
Cikli i studimit	Program i Ciklit të Parë të Studimit
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti "Eqrem Çabej" Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	**a.** Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. **b.** Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **c.** Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore **(portali U-albania).** *Përllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë* ***(për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).***

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit ***Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"*** ofron njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, si dhe aftësi specifike në fushën e mësuesisë për arsimin parashkollor.Ky program organizohet në jo më pak se 180 kredite. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome.Kërkesat gjithnjë në rritje për përgatitjen e studentëve në arsimin e lartë diktohen nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i vrullshëm i shkencës së arsimit dhe i teknologjisë së mësimdhënies.

Qëllimi i këtij programi është:

a. *Të pajisë studentët me dije dhe shprehi të nevojshme*, të shumëanshme dhe të larmishme, për të drejtuar me sukses procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit të fëmijëve, me qëllim që të formohen si qytetarë aktivë të shoqërisë demokratike.

b. *Të përvetësojnë metodologji të reja,* sidomos në fushën e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie, në fushën e pedagogjisë dhe të didaktikës, si dhe të thellojnë njohuritë në disiplina të ndryshme që lidhen me kurrikulën e arsimit parashkollor, në mënyrë që të zotërojnë kompetencat pedagogjike të nevojshme për të organizuar dhe menaxhuar me sukses edukimin dhe vlerësimin e fëmijëve.

c. *Të përgatisin specialistë në fushën e edukimit*, mësimdhënies, menaxhimit, organizimit dhe drejtimit, sidomos në arsimin parashkollor.

d. *Të përgatisin specialistë që do të zbatojnë konceptin bashkëkohor për procesin e të nxënit*, duke i dhënë përparësi rolit aktiv të fëmijëve në ndërtimin e njohurive dhe të kompetencave të reja, si dhe duke ndryshuar rolin e mësuesit, i cili duhet të jetë gjithnjë e më shumë udhëheqës dhe krijues i situatave të të nxënit.

Ky program është gjithashtu i domosdoshëm për shkak të rëndësisë që i është dhënë moshës së fëmijërisë së hershme (3-6 vjeç) në edukimin dhe zhvillimin e tyre, në përputhje me Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parashkollor, si dhe Kurrikulën bërthamë për klasat parashkollore dhe arsimin fillor.

Ky program studimi synon që të diplomuarit:

1. Të pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në arsimin parashkollor;
2. Të zhvillojnë kompetenca të përgjithshme për jetën dhe punësimin;
3. Të aftësohen për qasje të pavarur ndaj informacionit dhe përpunimit të tij;
4. Të jenë në gjendje të përzgjedhin dhe të vlerësojnë informacionin e rëndësishëm në një mjedis me informacion të bollshëm;
5. Të pajisen me aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe përballimin e situatave praktike;
6. Të zhvillojnë kompetenca që i ndihmojnë të zotërojnë botën e sotme digjitale;
7. Të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike;
8. Të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë shqiptare;
9. Të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Studentët që përfundojnë këtë program studimi do të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike bashkëkohore, të domosdoshme për t'iu përgjigjur me sukses kërkesave të tregut të punës. Ky program do të ndihmojë gjithashtu për të rritur rolin e universitetit si një qendër kërkimi dhe kualifikimi të gjithanshëm në rajon.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. Lëndë të formimit të përgjithshëm: Hyrje në psikologji; Pedagogji parashkollore; Arsimi gjithëpërfshirës; Kurrikula në arsimin parashkollor; Psikologji zhvillimi; Psikologji edukimi; Filozofi dhe sociologji edukimi; **Kredite: 36 ECTS**

2. Lëndë të formimit karakterizues: Matematikë; Gjuhë shqipe 1; Gjuhë shqipe 2; Art pamor dhe didaktikë; Letërsi për fëmijë; Edukim qytetar demokratik; Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit; Njohuri për gjeografinë; Histori e Shqipërisë; Muzikë dhe didaktikë; Edukim fizik, sporte dhe didaktikë; Shkencat e natyrës; Loja dhe edukimi në natyrë; Arte skenike (teatër dhe kërcim); Vlerësimi në arsimin parashkollor; Aftësim teknologjik; Didaktika e matematikës; Didaktika e diturisë së natyrës; Didaktika e shkencave shoqërore; Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik. **Kredite: 98 ECTS**

3. Lëndë integruese: Pedagogji e edukimit familjar; Kujdesi për veten, siguria dhe shëndeti; Etika profesionale e mësuesi; Psikologji sociale ose Komunikimi pedagogjik. **Kredite: 14 ECTS**

4. Lëndë me zgjedhje: Shkrim dhe menaxhim projekti ose E drejta për zhvillim; Psikologji sociale ose Komunikimi pedagogjik (nëse nuk është llogaritur më sipër). **Kredite: 6 ECTS**

5. Lëndë të formimit plotësues: Gjuhë e huaj; TIK në edukim; Praktikë profesionale. **Kredite: 32 ECTS**

6. Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome: Tezë diplome ose provim përfundimtar **Kredite: 5 ECT**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 - 84 pikë
9 (nëntë)	85 - 94 pikë
10 (dhjetë)	95 - 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma universitare ***Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"*** përbën një bazë të fortë për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe profesional në fushën e edukimit të fëmijërisë së hershme.Ky program, i ndërtuar mbi parime bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse të mësimdhënies, i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike që mundësojnë vazhdimin e studimeve në ciklet e mëtejshme, siç janë programet Master në Edukim Parashkollor, Edukim Special, Psikologji të Zhvillimit dhe Menaxhim Arsimor. Përmes formateve fleksibile të të mësuarit dhe zhvillimit të kompetencave profesionale, programi synon përgatitjen e mësuesve të aftë për të përballuar sfidat e tregut të punës, duke u përqendruar në nevojat e shoqërisë moderne për edukim cilësor në vitet e para të jetës së fëmijës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Tregu i punës po kërkon gjithnjë e më shumë mësues dhe edukatorë të kualifikuar në fushën e edukimit të fëmijërisë së hershme, të pajisur me njohuri pedagogjike, psikologjike dhe didaktike, të përshtatura me nevojat zhvillimore të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç.Ky profil përfshin aftësi për të organizuar mjedise edukative gjithëpërfshirëse dhe nxitëse, për të ndërvepruar me fëmijët përmes metodave aktive dhe për të zbatuar kurrikulat parashkollore në mënyrë të përshtatur. Pikërisht për këtë arsye, programi ***Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"*** synon të përgatisë profesionistë të aftë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës në institucione publike dhe private të arsimit parashkollor, qendra komunitare, organizata joqeveritare dhe projekte që mbështesin edukimin cilësor në fëmijërinë e hershme.

Të diplomuarit nga ky program mund të punësohen në:

1. **Kopshte publike dhe private**, si mësues të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç.
2. **Qendra komunitare dhe institucione edukative**, që ofrojnë programe përgatitore për arsimin fillor.
3. **Institucione dhe projekte që mbështesin edukimin për fëmijët dhe familjen**, në rolin e mësuesit, ndihmësit edukativ ose specialistit të zhvillimit të hershëm.
4. **Organizata joqeveritare dhe struktura ndërkombëtare**, që punojnë në fushën e arsimit parashkollor, zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe mbështetjes për familjet.
5. **Fusha të trajnimit dhe zhvillimit profesional**, si mentorë ose ndihmës-trajnues në programe edukimi për edukatorë të rinj.

Gjatë studimeve, studentët fitojnë njohuri dhe aftësi në:

- Zhvillimin fizik, kognitiv, emocional dhe social të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç;
- Metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit aktiv për këtë grupmoshë;
- Planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përqendruara te fëmija;
- Menaxhimin dhe ndërtimin e mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe nxitëse për mësim;
- Komunikimin e ndjeshëm dhe profesional me fëmijët, prindërit dhe kolegët;
- Zbatimin e parimeve të barazisë, etikës profesionale dhe përfshirjes në edukim.

Ky program përgatit mësues parashkollorë të aftë për të kontribuar në zhvillimin cilësor të fëmijëve në një shoqëri që gjithnjë e më shumë vlerëson dhe mbështet arsimin në vitet e hershme të jetës.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR " NË MËSUESI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në psikologji	**6**	**150**	**1**
2.	Pedagogji parashkollore	**5**	**125**	**2**
3.	Matematikë	**5**	**125**	**1**
4.	Gjuhë shqipe	**9**	**225**	**1&2**
5.	Art pamor dhe didaktikë	**12**	**300**	**1&2**
6.	Letërsi për fëmijë	**6**	**150**	**1**
7.	Pedagogji e edukimit familjar	**5**	**125**	**2**
8.	Gjuhë e huaj	**8**	**200**	**1&2**
9.	Përkujdesjet mjekësore në fëmijerinë e hershme	**6**	**150**	**2**
10.	TIK në edukim	**4**	**100**	**1**
Gjithësej viti i parë		**60 ECTS**	**1500**	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Arsimi gjithëpërfshirës	**5**	**125**	**1**
2.	Kurrikula në arsimin parashkollor	**5**	**125**	**2**
3.	Psikologji Zhvillimi	**5**	**125**	**1**
4.	Psikologji Edukimi	**5**	**125**	**2**
5.	Edukim qytetar demokratik	**5**	**125**	**1**
6.	Didaktika e gjuhë shqipe dhe e leximit	**5**	**125**	**1&2**
7.	Njohuri për Gjeografinë	**5**	**125**	**2**
8.	Histori e Shqiperisë	**5**	**125**	**1**
9.	Muzikë dhe didaktikë	**5**	**125**	**1**
10.	Edukim fizik, sporte dhe didaktikë	**5**	**125**	**2**
11.	Kujdesi për veten, siguria dhe shëndeti	**4**	**100**	**2**
12.	Etika profesionale e mësuesit	**3**	**75**	**1**
Lëndë me zgjedhje				
13.	1.Shkrim dhe menaxhim projekti	**3**	**75**	**1**
	2. E drejta për zhvillim	**3**	**75**	**2**
Gjithësej viti i dytë		**60 ECTS**	**1500**	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Filozofi dhe sociologji edukimi	**5**	**125**	**1**
2.	Shkencat e natyrës	**4**	**100**	**2**
3.	Loja dhe edukimi në natyrë	**4**	**100**	**1**
4.	Arte skenike (teatër & kërcim)	**4**	**100**	**1**
5.	Vlerësimi në arsimin parashkollor	**4**	**100**	**1**
6.	Aftësim teknologjik	**3**	**75**	**2**
7.	Didaktika e matematikës	**5**	**125**	**2**
8.	Didaktika e e diturisë së natyrës	**4**	**100**	**1**
9.	Didaktika e shkencave shoqërore	**4**	**100**	**1**
10.	Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik	**4**	**100**	**2**
Lëndë me zgjedhje				
11.	1. Psikologji sociale	**4**	**100**	**2**
	2. Komunikimi pedagogjik	**4**	**100**	**2**
12.	**Praktikë profesionale**	**10**	**250**	**1&2**
13.	**Detyrime përmbyllëse** (tezë diplome/provim përfundimtar)	**5**	**125**	**2**
Gjithësej viti i tretë		**60 ECTS**	**1500**	
Gjithësej VITI I, II & III		**180 ECTS**	**4500**	